



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova



Komuna / Opština / Municipality

PRIZREN

Numri i referencës	04-353/01-122852/24
Data e aplikimit:	10.09.2024
Data e lëshimit:	01.10.2024

Në bazë të nenit 6, 7, 13, 14, 15, 16, 18 dhe 19 të Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje (Gazeta Zyrtare Nr. 14, 20. Gusht 2018) dhe Ligji për procedurën e përgjithshme administrative në fuqi, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura në **Komuna e Prizrenit Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor – Sektori i Legalizimit me datë: 01.10.2024** nxjerr:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E CERTIFIKATËS SË LEGALIZIMIT

I. Ky Vendim lëshohet për aplikuesin dhe ndërtimin sipas kushteve të përcaktuara në tabelat e mëposhtme:

1. Aplikuesi për legalizim		A është aplikuesi përfaqësues i autorizuar?		Jo ☒	Po ☐
Emri:	Salajdin (Islam) Kabashi	Nr. i ID:			
Adresa:	Rr.Istriotet - Prizren				
Telefoni:		Emaili			

2. Ndërtimi për të cilin lëshohet ky vendim:

Adresa e ndërtimit (ose përshkrimi i lokacionit):	Rr.Istriotet - Prizren				
Emri i pronarit të regjistruar të parcelës:	Salajdin (Islam) Kabashi	Nr. i ID:			
Emri i pronarit të ndërtimit:	Salajdin (Islam) Kabashi	Nr. i ID:			
Zona Kadastrale:	Prizren	Nr. i Parcelës Kadastrale:	11621-0		

III. Përmbledhje e gjetjeve faktike

Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor – Sektori i Legalizimit i ka shqyrtuar të gjitha provat e paraqitura në këtë rast dhe ka trajtuar lëndën me **Nr: 04-353-01-122852/24** dhe dokumentet e dorëzuara sipas kërkesave të Nenit 4 (Procedurat e Aplikimit për Certifikatë të Legalizimit) të Udhëzimit Administrativ MMPH –Nr. 03/21, është konstatuar nga Komuna e Prizrenit se lënda e shqyrtuar ka plotësuar të gjitha dokumentacionet e nevojshme duke i evidentuar në faktet e mëposhtme:

1. Formulari standard i aplikimit për certifikatë të legalizimit për kategorinë I dhe Shtëpi të kategorisë II (mbi 450m²), është formulari që aplikuesi ka plotësuar dhe dorëzuar kërkesën për marrjen e certifikatës së legalizimit dhe në këtë formular gjenden të dhënat personale të aplikuesit të kërkesës, informatat rreth pronarit të ndërtimit dhe detajet e ndërtimit, dhe pas shqyrtimit të shtojcës 1 më pastaj është vazhduar me shqyrtimin e dokumentacionit tjetër të kësaj lënde.

2. Janë shqyrtuar të gjitha dokumentacionet e kësaj lënde, duke vërtetuar se lënda përmban dokumentacionet si në vijim:

2.1. Certifikatën e pronës me numrin e njësis kadastrale P-71813068- 11621-0 ZK Prizren e datës: 18.07.2024 ku është vërtetuar se Salajdin (Islam) Kabashi [Author] është pronar i ngastrës kadastrale me Nr. P-71813068- 11621-0 ZK Prizren e datës: 18.07.2024;

2.2. Kopja e planit me numrin e njësis kadastrale P-71813068- 11621-0 ZK Prizren e datës: 18.07.2024;

2.3. Kopjen e letërnjoftimit të pronarit të ndërtimit;

2.4. Matjet gjeodezike të dorëzuara nga gjeodeti i lincencuar ‘Adrian Kryeziu’ me numrin e Lincencës 162 me vlefshmëri deri më 29.04.2027 dhe kopjen e letërnjoftimit të gjeodetit.

2.5. Tre kopje fizike dhe një CD dixhitale (një kopje në original dhe dy kopje);

2.6. Fotografit e objektit të gjendjes ekzistuese;

3. Ne bazë të shtojcës 4. Shqyrtimi i aplikacioneve për të gjitha kategoritë, si dhe pas kontrollit të matjeve gjeodezike të vërtetuara nga ana e zyrtarit përgjegjës nga drejtoria për gjeodezi dhe kadastër është konstatuar se ndërtimi i ploteson kushtet e nevojshme për legalizim të objektit dhe është vazhduar me shtojcën 3. Formulari standard i aplikimit për lirim nga taksat për legalizimin e ndërtimit pa leje.

Koordinatat e vendndodhjes GPS:	Y=7479452.426	X=4675270.669
Sipërfaqja e parcelës ndërtimore:	378 m ²	

3. Informatat për ndërtimin:

Kategoria I dhe shtëpitë e kategorisë II ☒			
Shtëpi ☒	Shtëpi me afarizëm/komerciale (banim mbi 50%) ☐		
Garazh në shërbim të shtëpisë ☐	Objekt bujqësor (deri 600m ²) ☐	Depo e kategorisë I ☐	
Tjetër:			
Kategoria II (nuk përfshihen shtëpitë) ☐			
Banim me shumë njësi ☐	Konvikte apo ngjashëm ☐	Hotele apo ngjashëm ☐	
Afarizëm dhe administratë ☐	Industri, depo ☐	Art, kulturë, argëtim ☐	Arsim, shkencë ☐
Shëndetësi ☐	Sport, rekreacion ☐	Bujqësi ☐	
Tjetër:			
Ndërtim i përfunduar pa leje ndërtimi ☒		Tejkalimi i lejes së ndërtimit ☐	
Ndërtim i përfunduar me leje legalizimi ☐		Ndërhyrje pa leje në ndërtesë me leje ☐	
Sipërfaqja bruto e ndërtimit:	357.69 m ²	Numri i kateve:	B+P+1

II. Vendimi

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar dhe kushteve ekzistuese të ndërtimit, ky ndërtim **LEGALIZOHET në pajtim me kushtet e Ligjit 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa leje.**

1. Kjo certifikatë e legalizimit vërteton se ndërtimi pa leje plotëson kërkesat për legalizim sipas Ligjit 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe lejon shfrytëzimin e ndërtimit.
2. Ky Vendim për legalizim të ndërtimit pa leje, lëshohet vetëm për ndërtimin aktual. Çfarëdo pune ndërtimore shtesë në ndërtimin e legalizuar duhet të jetë në përputhje me ligjin në fuqi për ndërtim, ligjin në fuqi për planifikim hapësinor, planet hapësinore përkatëse dhe ligjet tjera në fuqi.
3. Për qëllim të regjistrimit të ndërtimit të legalizuar në kadastër, certifikata e legalizimit është e barazvlefshme me certifikatën e përdorimit.

4. Është vërtetuar se objekti i plotëson kushtet për lirim nga taksat për legalizim pasi që objekti gjendet në ortofoton zyrtare të vitit 2004 dhe sipas **Ligjit 06/L-024** për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje **neni 20 paragrafi 4.4**, objektet të cilat janë ndërtuar para vitit 2004 lirohen nga taksat për Legalizim.

Udhëzimi Juridik : Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në komunë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij Vendimi, duke zbatuar procedurën e Udhëzimit Administrativ të MMPH-së për procedurat e ankesës për vendimet mbi trajtimin e ndërtimeve pa leje në fuqi.


Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Inspektoratit të Komunës;
3. Arkivës së Komunës;
4. Drejtoris së Gjeodezis dhe Kadastrës;

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

NR. 04-353-01-122852/24 DT: 01.10.2024



D.U.P.H
Zyra e Legalizimit
Visar Islamaj